



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 115

Tiranë – E mërkurë, 2 gusht 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 168, datë 27.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 14095
Dekret i Presidentit nr. 169, datë 27.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 14095
Dekret i Presidentit nr. 175, datë 28.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 14095
Dekret i Presidentit nr. 176, datë 28.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 14096
Dekret i Presidentit nr. 177, datë 28.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 14096
Dekret i Presidentit nr. 178, datë 28.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 14096
Dekret i Presidentit nr. 179, datë 28.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 14097
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 26.7.2023	Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2024–2026 14097
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 26.7.2023	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030..... 14141
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 26.7.2023	Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës..... 14193
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 1.8.2023	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurive 1/54 dhe 1/44, me vendndodhje në njësinë administrative Tiranë, zona kadastrale 8160, dhe për disa shtesa në vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar..... 14197

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 1.8.2023	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Shkëlqim Agolli.....	14201
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 435, datë 25.7.2023	Për miratimin e “Rregullores për metodologjinë e përcaktimit të masës së dënimit në procesin e inspektimit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues pa licencë”	14201
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 439, datë 25.7.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Kosova.....	14204
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 440, datë 25.7.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Maqedonia e Veriut.....	14206



VENDIM
Nr. 483, datë 1.8.2023

**PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË
SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT
TË Z. SHKËLQIM AGOLLI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, dhe të vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Shkëlqim Agolli, në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 435, datë 25.7.2023

**PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES
PËR METODOLOGJINË E
PËRCAKTIMIT TË MASËS SË DËNIMIT
NË PROCESIN E INSPEKTIMIT TË
ZYRËS SË MBROJTJES NGA
RREZATIMET PËR SUBJEKTET QË
USHTROJNË VEPRIMTARI ME
BURIME RREZATIMI JONIZUES
PA LICENCË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 48, pika 8, të ligjit nr. 10433, datë 16.6. 2011, “Për

inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 10, pika 2, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullores për metodologjinë e përcaktimit të masës së dënimit në procesin e inspektimit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues pa licensë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**
Ogerta Manastirliu

RREGULLORE
**PËR METODOLOGJINË E PËRCAKTIMIT
TË MASËS SË DËNIMIT NË PROCESIN E
INSPEKTIMIT TË ZYRËS SË MBROJTJES
NGA RREZATIMET PËR SUBJEKTET QË
USHTROJNË VEPRIMTARI ME BURIME
RREZATIMI JONIZUES PA LICENCË**

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të parashikojë parimet dhe kriteret e përgjithshme mbi të cilat bazohet Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, këtu e në vijim “ZMR”, për përcaktimin e masës së dënimit administrativ në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar; nenit 48/8 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; nenit 7/1, 10, 18 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe rregulloreve përkatëse në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese.

Neni 2
Parimet bazë

1. Parimet themelore në bazë të të cilave udhëhiqet ZMR-ja janë: ligshmëria, barazia dhe mosdiskriminimi, proporcionaliteti, objektiviteti,



mbrojtja e të dhënave personale; parimi i drejtësisë dhe paanësisë.

2. Në përcaktimin e masës së dënimit, në rastin kur ligji ka parashikuar kufij minimalë e maksimalë të vlerës së gjobës, ZMR-ja shqyrton kundërvajtjen administrative duke marrë parasysh:

- a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
- b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
- c) rëndësinë e kundërvajtjes;
- d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

Neni 3

Kriteret për caktimin e masës së dënimit administrativ

1. Rriskun që paraqet veprimtaria bazuar në frekuencën e rriskut dhe pajisjet/burimet radioaktive që ka në përdorim subjekti i inspektuar.

2. Rreziku që mund të krijohet për shëndetin e punonjësve, të popullatës dhe dëmtimi i mjedisit.

3. Nëse subjekti kundërvajtjes rezulton, se është i dënuar /i padënuar administrativisht për shkeljen e konstatuar.

Neni 4

Mënyra e caktimit të dënimit

1. Sanksioni administrativ që zbatohet për çdo shkelje caktohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit në raport me shkeljen e konstatuar, nenin 10 të ligjit nr. 8025/1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, të ndryshuar, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, mbi kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe parashikimet e kësaj Rregulloreje.

2. Në rastin kur subjekti vijon të kryejë aktivitetin pa licencë dhe rezulton të jetë përsëritës i së njëjtës shkelje administrative, ZMR-ja vendos dënimin maksimal me gjobë, duke mbajtur në konsideratë rrethanat rënduese, rriskun që paraqet veprimtaria me burime rrezatimi jonizues, sipas parashikimeve të kësaj Rregulloreje.

3. Subjekti informal që ushtron veprimtari me burime rrezatimi jonizues, i cili refuzon të identifikohet apo në rastet kur ZMR-ja e ka të vështirë e të pamundur identifikimin e tij, ka të drejtën të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit që ka

kryer kundërvajtjen administrative, bazuar në nenet 37 dhe 42 të ligjit nr. 1043,3 datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Përveç sanksionit administrativ të vendosur për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë Rregullore, ZMR-ja merr masa urgjente kur subjektit të inspektuar i konstatohen nivele të larta të rrezatimit tej normave të lejuara, ndotje të mjedisit që kërcënojnë shëndetin e popullatës, apo situata që krijojnë emergjencë radiologjike.

Neni 5

Sanksionet administrative

1. Sanksionet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë Rregullore janë:

- a) paralajmërim;
- b) dënim administrativ ku sanksionohet masa e gjobës;
- c) dënim administrativ bllokim/pezullim aktiviteti.

2. Sanksioni “paralajmërim” është akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e afatit për kundërvajtësit, për të respektuar/zbatuar parashikimet e ligjit nr. 8025/1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, të ndryshuar, duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit publik, apo kur ekzistojnë rrethanat lehtësuese.

3. Në rast të ushtrimit të veprimtarisë me burime rrezatimi jonizues, në kundërshtim me nenet 4 dhe 5 të ligjit nr. 8025/1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, të ndryshuar, ose përsëritjeje të kryerjes të së njëjtës kundërvajtje apo të një kundërvajtjeje administrative tjetër sipas kësaj rregulloreje apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobë.

4. Dënimi administrativ bllokim pezullim aktiviteti përcaktohet si masë urgjente në pikën 7/b të VKM-së nr. 10/2010, “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime rrezatimi jonizues”, në rastet kur subjektit i konstatohen nivele të larta të rrezatimit tej normave të lejuara, ndotje të mjedisit që kërcënojnë shëndetin e popullatës, apo situata emergjente.



Neni 6

Lloji dhe masa e dënimit për kundërvajtjet administrative

1. Dënimi administrativ kryesor “Paralajmërim” për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues, kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X ose burime radioaktive që nuk janë të pajisur me licencë ose subjekte informale, që inspektohen për herë të parë, ju përcaktohet afati deri në 60 ditë për aplikimin në ZMR dhe dorëzimin e plotë të dokumentacionit për t’u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë me burime të rrezatimit jonizues.

2. Dënimi administrativ kryesor “Gjobë”, në masën 100.000 lekë, për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues (gjeneratorë me rreze X, burime radioaktive kategoria 4, 5), të cilëve:

a) ju ka përfunduar afati i licencës dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore;

b) kanë aplikuar për licencë/rinovim licence, por nuk e kanë përfunduar procedurën administrative brenda afatit për t’u pajisur me licencë dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore.

3. Dënimi administrativ kryesor “Gjobë”, në masën 200.000, për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues (burime radioaktive kategoria 3), të cilëve:

a) ju ka përfunduar afati i licencës dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6 pika 1 të kësaj Rregullore;

b) kanë aplikuar për licencë/rinovim licence, por nuk e kanë përfunduar procedurën administrative brenda afatit për t’u pajisur me licencë dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore.

4. Dënimi administrativ kryesor “Gjobë”, në masën 300.000, subjektit të inspektuar që ushtron veprimtarinë me burime rrezatimi jonizues pa licencë (burime radioaktive kategoritë 1 dhe 2) të cilëve:

a) ju ka përfunduar afati i licencës dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore;

b) kanë aplikuar për licencë/rinovim licence, por nuk e kanë përfunduar procedurën administrative brenda afatit për t’u pajisur me licencë dhe nuk kanë

zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore.

5. Dënimi administrativ kryesor “Blokim i aktivitetit me burime rrezatimi jonizues”. Dënimi administrativ kryesor “Blokim i aktivitetit” hyn te masat urgjente dhe merret kur subjektit të inspektuar i konstatohen nivele të larta të rrezatimit tej normave të lejuara, ndotje të mjedisit që kërcënojnë shëndetin e popullatës, apo situatash emergjente etj., sipas nenit 43, pikat 1/a dhe b, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Dënimi administrativ kryesor “Blokim i aktivitetit” aplikohet si dënim në subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues të kategorive I, II ose III deri në momentin e ushtrimit të veprimtarisë, në përputhje me kërkesat ligjore. Blokimi i aktivitetit mund të shoqërohet edhe me dënime të tjera plotësuese.

Neni 7

Rrethanat lehtësuese

1. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethana lehtësuese jepet dënimi administrativ me paralajmërim ose dënimi administrativ në minimum të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje. Rrethana lehtësuese janë rrethanat si vijon:

a) kundërvajtësi është në proces administrativ për rinovimin e licencës dhe nuk rezulton përsëritës i kësaj shkelje më parë;

b) kundërvajtësi ka eliminuar vullnetarisht pasojat e ardhura nga shkelja e kryer, subjekti ka qenë në pamundësi objektive për të rinovuar licencën (për shkak të rrethanave të rënda personale).

Neni 8

Rrethanat rënduese

1. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethana rënduese, jepet dënimi maksimal i masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje. Rrethana rënduese janë rrethanat si vijon:

a) kundërvajtësi vazhdon veprimtarinë e paligjshme edhe mbas kërkesës për ta ndërprerë atë;

b) veprimtaria me burime rrezatimi jonizues paraqet rrisht të lartë;

c) subjekti është ripërsëritës i së njëjtës shkelje.